

## Fjalim i deputetes Flutura Aça

03.07.2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Përpara se të flas për SPAK-un, për fat të keq zoti Dumani nuk është, por besoj se na ndjek, do të doja të merresha me ftesën publike që na bëri zoti Balla (sigurisht që e falënderoj), që u pasua nga përdëllimi i zonjës Spiropali. Por jam shumë kurioze të di, nëse janë të ftuar të gjithë kolegët e mi, sepse, nëse nuk janë ftuar, do të ishte një gjë shumë e shëmtuar, sepse nuk e vendos Protokolli i Shtetit se cilët janë dhe cilët nuk janë deputetë, por e vendosin zgjedhësit shqiptarë! Megjithatë, ne të gjithë e dimë se kjo është një ceremoni pothuajse private, edhe pse bëhet nëpërmjet shtetit. Shumë mirë që është ftuar, por ne kemi qenë këtu bashkë kundër ligjit të medaljeve, i cili ia zhveshi të gjitha këto merita Presidentit, kështu që nuk e di se çfarë roli ka dhe sa është përfshirë ai në këtë vizitë. Siç thotë edhe vetë zoti Rama në një shkrim të tij të viteve '95, ka një shenjë të veçantë, një yll te vendi që nuk thuhet, tani i ka marrë yjet dhe do t'ia japë kujtdo që hyn e del nga Shqipëria, gjithsesi shumë mirë bën! Personalisht do të marr pjesë në këtë ceremoni, jo prej ftesës, as për ndonjë respekt karshi zotit Rama (absolutisht jo, aq më shumë edhe prej asaj që ka bërë me medaljet, e cila është fyese për Presidentin, për të cilën kam qenë totalisht kundër), por do të shkoj si shenjë respekti personal ndaj Bill Klintonit; mbi të gjitha, do të shkoj në respekt të Kosovës, aq më shumë që tani “Open Balkan”, siç e patë edhe vetë, i ktheu patkonjtë nga dielli, e hodhët vetë në kosh.

Tani po i kthehem çështjes sime. Gjatë vitit 2017, teksa shkruaja romanin tim të radhës “Të ftuar në Rrethin e Dhjetë”, ku jam marrë edhe me politikanët keqbërës të tranzicionit shqiptar, u rreka të gjeja emrin e një vendi ku do t'i degdisja ata, të themi, si një lloj torture morale, një formë ndëshkimi publik, ngaqë i kishin tradhtuar shqiptarët në ëndrrën e tyre për ta bërë Shqipërinë si e gjithë Europa. Kështu subkoshienca, mjeti i zejes sime, më çoi te koncepti “i rrethit të dhjetë”, në burgun e vuajtjes së mëkatit që nuk gjenden as në trojet biblike, as në ato të “Ferrit” të Dantes, nëpër nëntë rathët e të cilit njerëzit ndëshkohen sipas një mëkati të vetëm që e kanë dhe ku mbetet ende një veshtulli njerëzore. Në “rrethin e dhjetë” do të ishte vendi i politikanëve keqbërës, me kompleksin e mëkateve, fajeve dhe veseve, me të tillë model makiavelist që shkel çdo kod, kur e moralshme është të vjedhësh, kur e ndershme është të korruptosh, kur e pranueshme është të dhunosh e kur e duartrokitshme dhe e votueshme (edhe me vota të vjedhura) është që njëherësh të vjedhësh, të korruptosh, të dhunosh, të tallesh e të bullizosh individë e komunitete. Të mos flasim pastaj për seksomaninë akute që të jep pushteti, që nuk është sanksionuar në asnjë kontratë të këtij shteti. Kështu, në të vërtetë, pa e ditur as vetë, unë kisha bërë thirrje për një institucion të lartë skanimi moral, politik dhe njerëzor, i cili mungonte ndër shqiptarë dhe, si për ta përmbushur profecinë time, do të thirrej shumë shpejt “SPAK”, një filtër që do të pastronte politikën shqiptare përmes drejtësisë, të cilën Aristoteli e quante “Politika e politikave”.

Kështu, i nderuar zoti Dumani, edhe pse mungoni këtu, në “portën e rrethit të dhjetë të Ferrit” me emrin SPAK, ju nuk jeni as Shën Pjetri me çelësa në duar, as rremtari i varkave nëpër Akeron, as shqytari që mban levën e gijotinës, por ju jeni zëdhënësi i vullnetit tonë për drejtësi. Po jua përsëris: ju jeni zëdhënësi i vullnetit tonë për drejtësi! Ju jeni drejtësia jonë e munguar. Për shkak të këtyre politikanëve keqbërës, në këta tridhjetë vjet ne nuk kemi bërë shtet. Me po atë thirrje të aktit të parë të Hamletit: “Something is rotten in the state of Denmark”, ju kujtoj publikisht, i nderuar zoti Dumani, të nderuar prokurorë të SPAK-ut, të nderuar zotërinj eminenca gri, që ishit sot këtu dhe u larguat, se diçka është thyer në shtetin e shqiptarëve, kështu që është në barrën tuaj ta gjeni atë thyerje dhe në barrën tonë politike ta riparojmë atë thyerje bashkë. Këtë duhet ta bëjmë para se të na ikin të gjithë shqiptarët nga Shqipëria, sepse, mes dhjetëra arsyeve të ikjes së tyre, ka një arsye që i mërzit ata me atdheun e tyre: vakuumi i së drejtës, ose pandëshkueshmëria, siç thuhet rëndom.

Para se ta drejtoj gishtin te ju nëse e keni bërë mirë apo keq punën tuaj, po e nis nga ky parlament, ku shpesh na pëlqen ta ndajmë politikën nga morali, nga etika, nga turpi dhe nga higjiena politike. Të më falin disa kolegë shumë të nderuar, njohjen me të cilët këtu e kam privilegj, ata nuk përfshihen në këto rreshta. Po flas për atë pjesë që i shërben bandës me pushtet, duke na kthyer edhe ne pjesë të saj, qoftë edhe si spektatorë. A nuk kemi kaluar ne këtu ligje nominative për koncensione, për ulje taksash, kur e kemi ditur të gjithë se cilët oligarkë po “dorovisim”?! A nuk i kemi vënë ne ligje të caktuara në shërbim të kompanive të miqve tanë?! A nuk e kaluam këtu, me një të rënë të lapsit, portin e Durrësit, edhe pse do ta kthejë Durrësin në Dubain e ri, mbi të gjitha, në kryeqendrën europiane të prostitucionit e drogës?! Ja si ai Dubai që tronditi me karkasat e shndritshme, që fshihnin ngrehinat e zbrazura, edhe vetë të ndjerin Berluskoni, kur vizitoi Dubain, i cili, edhe pse një nga njerëzit më të pasur të Italisë, nuk mundi dot kurrë as të ëndërronte ta bënte këtë në ndonjë cep të Italisë antike, sepse antikitetin nuk e konkurron dot asnjë lloj moderniteti, me çfarëdo parash që të mundohesh ta blesh. A nuk ua kemi dhuruar këtu me vota primitive Butrintin miqve të pushtetit, mes të cilëve janë edhe ca antishqiptarë të rafinuar, pa u shqetësuar fare se shumë shpejt ne shqiptarët do ta gjejmë veten në historinë e botës, shkruar nga sharlatanë dhe profanë, si një çetë kaçakësh me origjinë bastarde, siç na dizenjojnë armiqtë, pasi edhe lahutën ua falëm sllavëve, edhe me iso-polifoninë “dorovitëm” grekët dhe fjalën “besa” e deformatim në muze për hebrenjtë, edhe pse është e lidhur ekskluzivisht me fenomenin e gjakmarrjes, si pjesë e identitetit tonë të patjetërsueshëm?!

Po çfarë bëtë ju, zotërinj prokurorë, me këtë enumeracionin e së keqes, e cila është vetëm një fragment i vogël i saj? Çfarë bëtë ju me sistemin e patronazhimit? 900 mijë shqiptarë janë përgjuar deri te fryma, shtrati, sëmundjet personale dhe zënkat me fqinjët. Çfarë bëtë ju për ta sjellë në vend dinjitetin e tyre? Asgjë, ju e shitët çështjen e patronazhistëve diku tjetër për moskompetencë. Çfarë bëtë ju, zotërinj, me dosjet nr. 184 dhe nr. 339 të zgjedhjeve të 15 prillit 2021? Asgjë, e shitët atë si një gjë shumë të vogël për t’u marrë ju “njerëzit e mëdhenj”, edhe pse bandat kriminale bënë kërdrinë cep më cep të Shqipërisë në solidaritet të plotë me shtetin. Nuk di në ka ndonjë gjë më të madhe në këtë vend se të prekësh vullnetin e popullit në demokraci. A mund t’ua thoni shqiptarëve, nëse ia dini rrënjët dhe degët, burimet financiare të ndonjërit prej këtyre kullave të larta që keni

para syve? Prokuroria italiane jua dha me zë e me shkrim përfshirjen e kryetarit të Bashkisë së Tiranës nëpër allishverishe me Ndrangheta-n. Ju nuk guxonit ta prekni atë as për çështjen e inceneratorëve, edhe pse edhe bufi e di rolin e tij në vjedhjen që u bëhet çdo ditë qytetarëve të Tiranës me plehrat që nuk digjen. Ju nuk e prekni, sepse siç i tha një taksisti një kolegu juaj, i mbetur peng në trafikun e tmerrshëm të Tiranës në një natë shiu, nuk e prekin dot “kryeministrin e ardhshëm”, siç ia ka mbushur ai mendjen vetes, mjedisit që e rrethon, mbase edhe juve. Ju i shërbyet atij në këtë ambicie, duke ia hequr qafe sfidantin e tij më të madh, siç do t’ia hiqni edhe ndonjë sfidant apo sfidante tjetër kur t’i vijë radha.

Lexoni shkrimin e fundit të “Reporter”, të shihni gjëmën ekologjike që po i ndodh lumit të Erzenit në të gjithë territorin që lag ai, prej landfillit të Sharrës deri në det. Nga të mbjellat e vaditura nga ato ujëra ushqeheni edhe ju, zotërinj prokurorë. Ndihmoheni shtetin që të mos e konkurrojë shtetin, por bëjeni këtë jo duke i ardhur rrotull oborrit të korrupsionit dhe duke investiguar e duke hapur dosje për kundraxhinjtë dhe portierët e pallatit të korrupsionit, ose për disa oborrtarë periferikë, por merruni me princërit e vërtetë dhe guxonit t’i afroheni sadopak “mbretit të korrupsionit” ose “mbretërve të korrupsionit”, se kemi disa.

I keni të gjitha privilegjet që shqiptarët mund t’ju garantojnë; e keni të gjithë pushtetin e mundshëm, por shqiptarëve, që ju kanë dhënë këtë privilegj, mos u kërkoni të bëjnë për ju edhe pagesën e frikës. Ngrihuni në lartësinë e përgjegjësisë për të cilën jeni mandatuar, duke mos harruar se “mishi juaj mund të ketë frikë, po ju kurrsesi”, siç thotë diku Borhesi. Mbase kërkojmë shumë, të themi se duam standarde europiane të drejtësisë, por nuk duhet të jemi bishti në rajon, siç ka ndodhur deri tani. Mjaftojnë shembujt e Kroacisë, Bosnjës, Bullgarisë, Rumanisë, edhe i Maqedonisë së Veriut, po deshët, ku dy kryeministrave “iu qëndis tatuazhi i korrupsionit” nga drejtësia funksionale. Të mos flas pastaj për Kosovën që po bën shtet europian, sepse, po t’ua kujtoj atë, ju bie të fikët, sepse ju kujtoj turpërimin që ju bëri Kosova me refuzimin e “Open Balkan”, për të cilin në këtë foltore u keni shitur aq shumë gënjeshtër shqiptarëve, aq sa e hodhët edhe vetë në kosh nga turpi, që të mos ju shënohej si akt antikombëtar nga historia.

Faleminderit!